

ARISTOTEL MICI

ELEKTRICISTJA  
E BETONIERES

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

854-32  
M 70

TREGIME

8JH-32

—  
M 70

ARISTOTEL MICI

# ELEKTRICISTJA E BETONIERËS

tregime



2638

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## ELEKTRICISTJA E BETONIERËS

Qe e para elektriciste që vinte në atë kantier, andaj të gjithë u bënë kureshtarë ta njihnin. Interesimet për të filluan që atë mbrëmje kur u hap lajmi se në betonierë do të vinte një vajzë. Natyrisht më shumë u bënë kureshtarë djemtë, por edhe kureshtja e tyre erdhi e u zvogëlua, kur u mor vesh se ajo ishte e fejuar. Këtë gjë e dinte mirë sidomos banakieri i bufessë, i cili kishte të bënte me burrin e tezes së saj. Bufetieri thoshte se ai i kishte rregulluar Vjollcës një fat të mrekullueshëm.

Javët kaluan dhe ajo u njoh me njerëzit e repartit. Nuk e pati të vështirë të mësohej me jetën e kantierit. Ajo ngrihej herët si të gjithë, punonte me turne dhe hante në mensë. Kjo jetë për të u bë e zakonshme. Kur futej në mensë, shumë vështrime ktheheshin drejt saj. Ata që akoma s'ia dinin emrin, e thërritnin «Sykaltra». Si elektriciste, duhej të merrë vetëm me elektromotorin, por ajo nuk rrinte e mënjanuar nga punëtorët. Shpesh bashkë me ta mbushtë me çimento dhe zhavorr tamburin e betonierës.

Në mbrëmje u shkarkuan disa makina me zha-

vorr. Meqë kishte dhe gurë të mëdhenj, duhej bërë pastrimi, të hiqeshin gurët e mëdhenj veç e të çoheshin te gurëthyesja, para se të grumbulloheshin në lavatriçe. Kjo ishte një punë që donte shumë njerëz. Midis atyre që filluan pastrimin e pиргут me zhavorr ishte edhe Vjollca, që dallohej midis të tjerëve nga një shami ngjyrë limoni, me të cilën kishte lidhur flokët.

Në mbarim të turnit erdhi dikush dhe kërkoi Vjollcën. Ishte bufetieri, që e lajmëroi se po e priste burri i tezes. Vjollca lidhi mirë shaminë pas flokëve, shkundi duke ecur pluhurin e kominosheve dhe u nis ta takonte. Ai kishte qëndruar pas repartit të hekurthyesve dhe s'dallohej mirë. Burri i tezes iu afrua, e përqafoi dhe i tha:

— Po ç'je bërë kështu, moj çupë? Gjithë pluhur cimentoje!

— Ç'të bësh, — foli ajo, — kështu e ka puna në betonierë.

— S'ka gjë, s'ka gjë, — shtoi ai, — punë e shëndet, kjo është kryesorja.

— Si është tezja? — pyeti Vjollca.

— Mirë është, mirë; ka merak për ty. Ajo dhe jot ëmë nuk të lënë nga goja.

Vjollca buzëqeshi, kurse burri i tezes vështroi anës dhe vazhdoi:

— Sa për tezen... ajo vdes për ty fare. Ne kemi pesë djem dhe asnjë çupë, prandaj i pikon zemra për një vajzë.

Vjollca dëgjonte si me mosbesim e, duke parë me bisht të syrit, mendonte se diçka duhej të fshihej prapa atij kujdesi e atyre lajkave pak të tepruara. Ishte mes jave dhe kuptohej se burri i tezes nuk që nisur kot deri në kantier për ta takuar.

— Po pse je munduar? — i tha Vjollca.

— U bëmë merak, moj çupë, u bëmë merak.

Dy të shtuna pa ardhur!

— Kemi pasur punë, xhaxhi Fani, — iu përgjigj ajo, — është ngritur një repart i ri që do shumë beton.

— Mirë, moj bijë, puna punë, po ti ke dhe familje. Pastaj je dhe e fejuar, s'duhet t'i japim shkas tjetrit për dyshime.

— Kështu e ka kantieri, xhaxhi Fani.

— Ashtu është vërtet, moj bijë, në kantier punët dalin njëra pas tjetrës çdo orë. Po di ç'të bësh ti? Kërko ndonjë punë andej nga qyteti. Duhet të ketë ndonjë vend bosh nga ndërmarrja elektrike, nga komunalja.

— Unë sapo erdha, s'kam shkelur mirë akoma, xhaxhi Fani, si të bëj kërkesë për t'u larguar? — i tha ajo burrit të tezes.

Pastaj të dy, pasi hynë nëpër dyqanet e kantierit, u drejtuan nga stacioni i autobusave. Para se të priste biletën, ai i tha Vjollcës:

— Mos harro të na vish të shtunën nga shtëpia për darkë. Kemi një gosti të vogël, meqë mbaroi Drita shkollën.

— Me Dritën jemi si motra, patjetër do të vij.

— Për Lakon s'ke ndonjë porosi? — e pyeti ai për të parë se ç'do të thoshte ajo për të fejuarin,

— Po ç'të them, ai vjen vetë këtu.

— Ah, ç'djalë është ai! S'i gjendet kollaj shoku. Pa shiko, edhe pse s'ka punë nga kantieri, prapë vjen këtej vetëm e vetëm nga dashuria! — tha burri i tezes më në fund dhe hipi në autobusin urban që po nisej.

Atë mbrëmje, me të ikur burri i tezes, erdhi i

fejuari i saj, Lakoja. Ai vinte në kohë në ndryshme, kur Vjollca nuk e priste fare. Po, megjithëse vinte shpesh, ai s'para dukej i qeshur si gjithë të fejuarit. Sytë e tij dukeshin të menduar dhe në ballë i formoheshin rrudha. Kishte një farë shqetësimi në vetvete, që nuk e thoshte dhe mundohej ta fshihte, por ajo e kishte kuptuar arsyen pse ishte mërzitur. Ai rrinte pak i dëshpëruar për shkak se ajo nuk kishte dashur të largohej nga kantieri. Ai i kishte gjetur vende të qeta në qytet, por ajo s'donte të largohej e të ndërronte punë.

Vjollca e dëgjonte në heshtje dhe nuk po e kuptonte dot këmbënguljen e Lakos për ta larguar nga betonera. Ajo vriste mendjen dhe s'po dinte si ta kuptonte këtë kërkesë. «Mos e bën se do të më rehatojë, — thoshte Vjollca me vete — apo vuan se unë punoj midis punëtorëve, midis djemve, që ai nuk i njeh? Po të jetë kështu, ai nuk ka besim tek unë.»

— Ku ka më mirë sesa elektriciste në plazh? — i thoshte Lakoja atë mbrëmje. — Bën edhe punë, edhe jetë të mirë. Atje ke jodio, ajër të pastër, det të freskët dhe rërë të ngrohtë; kurse këtu, ç'ke këtu?! Vetëm... zhurmë dhe pluhurin e betonierës.

— Ashtu të duket, po këtu ka njerëz shumë të mirë, Lako. Ec bëj këtu punën në prodhim që ta kuptosh dhe ta ndiesh jetën e kantierit.

— Atë e kam të qartë, unë, — u dëgjua Lakoja, — po e kam fjalën te shëndeti.

— E ke gabim, — i tha përsëri Vjollca. — Pse, kush janë më të fortë dhe të shëndetshëm, punëtorët e kantierit, apo nëpunësit e zyrës sate?

— Me detin unë nuk barazoj asnjë, — shtoi Lakoja.

— Plazhi më pëlqen dhe mua. Të kalosh pesëmbëdhjetëdëshin atje, e ku ka më mirë!

— Unë po përpinqem që t'i të kalosh rehat-rehat gjithë verën, jo vetëm pesëmbëdhjetë ditë.

Këto fjalë i kujtuan Vjollcës burrin e tezes, se afërsisht ashtu fliste edhe ai. «Duket që këta u marrkan vesh midis tyre — mendoi ajo. — Jo më kot thonë se lajmësi udhëton mbi këpucët e dhëndrit. Diçka bluajnë në mendjen e tyre». Kështu mendonte Vjollca dhe iu kujtua koha kur e fejuan ca muaj para se të mbarontë shkollën: Tezja, burri i i tezes dhe ca miq të tjerë ditë për ditë do t'i flitnin për Lakon. E ngrinin Lakon në qiell dhe e mburrnin kush e kush më shumë, se ishte në qytet, se kishte diplomë, punë të mirë, shtëpi të kompletuar. Mbi të tërë e lavdéronte burri i tezes, se e kishte në qendrën e punës. — «Në shtëpinë e tij gjendet dhe qu-mësht dallëndysheje, — i tha ai një herë nënës së Vjollcës, me të cilën fliste fare pa drojtje si kunatë që e kishte.

— Rast i mirë, — i tha ajo, — po duket ca i madh.

— Burri e plak gruan, nuk e plak gruaja burrin, prandaj ka qenë në çdo kohë burri më i madh se gruaja, — ia ktheu burri i tezes.»

Vjollca në fillim nuk kishte pranuar, pastaj kishte heshtur dhe më vonë nuk i kishte bërë dot ballë presionit, që e rrethonte.

« — Gjithë këto fate të kanë ardhur, — i thoshte tezja, — vendos për një, se nga qelli nuk do të zbre-së ai yti.

— Po si të vendos, moj teze, pa u njobur, pa u dashur fare?

— Ooo dhe ti, dashuria!... Dashuria vjen dhe pas fejesës.»

Vjollcës i qe mbyllur goja. Nuk bëri dot më qëndresë. Kishte pranuar dhe po priste që t'i lindte dashuria pas fejese.

Ndërsa Vjollca po përfytyronte kështu ditët e para të fejesës, Lakoja po thoshte:

— Meqë nuk të pëlqen elektriciste në plazh, ç'do të thuash për ndërmarrjen elektrike? Nuk është më mirë se këtu?

— Pse do të më ndash nga shokët dhe shoqet e klasës? — tha ajo. — A e di sa prej tyre kanë ardhur në kantier?

— Nuk e kam fjalën që të të ndaj, por të të sjell brenda në qytet, në një qendër ku ke mundësi të aftësoshe më shumë nga ana profesionale.

— Këtu ia kam marrë dorën punës, Lako, dhe e kam të vështirë të largohem nga kolektivi, — tha ajo.

— Po ti s'bëhesh merak fare për dëshirat e mia! S'të kuptoj, — tha Lakoja dhe u nda duke e përshtendetur ftohtë. Iku ashtu si erdhi, i mërzitur, i menduar. Vjollca u nis për në fjetore, duke pritur që t'i lindte dashuria pas fejese, ashtu siç kishte thënë dikur tezja. Por dashuria nuk po i zgjоhej!..

\* \* \*

Një pasdite tjetër, Lakoja erdhi prapë në kantier, por më i qeshur e më i gjëzuar. Të paktën ashtu dukej. Kishte sjelli me vete një qeskë nailoni plot me rrush. E lau rrushin në çesmë me ujë të boll-

shëm dhe u ul në bar-bufe për të pritur Vjollcën kur të mbaronte turnin.

— Kur ke ndër mend ta bësh dasmën? — e pyeti bufetieri.

— Nga fundi i muajit tjetër, — u përgjigj Lakoja.

— Mirë bën — shtoi bufetieri, — erdhi koha, s'ka lezet më të zgjatet koha e fejesës!

Si mbaroi turni, Lakoja doli ndanë rrugës, ndenji pak duke përgjuar rrugën dhe ja tek pa atje tej, duke ngjitur të përpjetën e vogël të rrugës me kalldrëm, Vjollcën që vinte bashkë me shoqet e re-partit.

Asaj i erdhi mirë që ai nuk ishte i mërzitur. «Siq duket — tha ajo me vete — do të ketë hequr dorë nga mendimi për të më larguar nga kantieri.»

U ulën në hijen e një ulliri aty pranë. Duke ngrënë rrush, Lakoja foli për martesën.

— S'kemi ç'presim më, — tha ai, — në fillim të shtatorit mendoj të bëjmë dasmën.

— Si shumë shpejt, — i tha ajo, — unë vetëm dy muaj kam në punë.

— Po pse të presim? — u dëgjua zëri i tij. — Mua s'më mungon asgjë. Lekë kam në arkën e kur-simit, pajën ta bëj shpejt e shpejt.

Vjollca rrudhi ballin. I ra nga dora veriga e rrushit dhe vështroi përreth. Kantieri ziente. Me dhjetëra kamionë, motokarro, vinça, skreperë e bulldozjer lëviznin duke bashkuar uturimat e tyre në një buçimë të vetme. Atje, te kodra e vogël, nën hijen e ullirit ajo e ndjeu veten midis dy botëve. Nga njëra anë ishte Lakoja, shtëpia me bahçë e me pemë, ku kishte edhe «qumësht dallëndysheje» dhe nga ana tjetër shoqet dhe shokët e kantierit. Nga

njëra anë ishte fisi, zakonet, mirësjellja me një lloj delikatese të shtirur, kurse nga ana tjetër ishte vrulli dhe buçima e kantierit, njerëzit që ngjiteshin nëpër lartësi dhe që ngrinin një vigan prej ferrobetoni. Kështu, edhe për afatin e dasmës ata nuk u morën vesh.

\* \* \*

Një herë tjetër i fejuari i Vjollcës erdhi paradreke. Atë ditë vinçi-kullë kishte shumë punë. Ka voja e tij lëvizte pandërprerë. Furnizonte me beton repartin e paratensionimit, kështu që edhe betoniera e re duhej të prodhonte pa pushim. Vjollca qëndronte në gatishmëri tek aparatura për t'i dalë përparrë çdo të papriture.

Po atë ditë në kantier kishin ardhur edhe dy njerëz me lapsa dhe karton nëpër duar. Dikush ata i kishte marrë për gazetarë, tjetërkujt i qenë dukur gjeometra. Njerëzit e porsaardhur, që mbanin ndër duar lapsa dhe kartonë, si vështruan rreth e rrotull, u ulën mbi ca gurë, afër themeleve të hapura. Atje çoc shkruanin mbi letrat e bardha e mbi kartonin e trashë.

Pas një gjysmë ore u mor vesh se ata ishin piktorë. Njëri vizatonte betonierën dhe tjetri vinçin. Midis dy objekteve kishte njerëz. Paradreke piktorët u morën vetëm me panoramën e përgjithshme. Tek vizatonin peisazhin, ata vështronin dhe tipa punëtorësh interesantë me tipare të vizatueshme.

Në mesditë, në kohën kur punëtorët niseshin për në mensë, piktorët bënë edhe portrete. Këto skica